

Raport nga monitorimi i cilësisë së debatit në Kuvendin

shtator - dhjetor 2017



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**



**Институт за демократија
Социетас цивилис - Скопје**

Raport nga monitorimi i cilësisë së debatit në Kuvendin

(shtator - dhjetor 2017)

Ky publikim është përgatitur me ndihmë të Agjencisë Zvicerane për përkrahje dhe zhvillim.

Përmbajtja e publikimit është përgjegjësi vetëm e Institutit për demokraci “Societas civilis” – Shkup (IDSCS) dhe në kurrfarë mënyrë nuk mund të llogaritet se i reflekton pikëpamjet e Agjencisë Zvicerane për përkrahje dhe zhvillim

Instituti për demokraci “Societas civilis” – Shkup (IDSCS), prej qershorit të vitit 2014, e përcjell cilësinë e debatit në Kuvendin dhe raportimin mediatik për punën e Kuvendit. Monitorimi në ciklin e parë u zhvillua gjatë 10 muajve, përkatësisht nga qershori i vitit 2014 deri në maj të vitit 2015. Prej shtatorit të vitit 2015 monitorimi dhe vlerësimi i cilësisë së debatit parlamentar vazhdon, i përkrahur nga Agjencia Zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim dhe do të zgjas deri më dhjetor të vitit 2017. Monitorimi në këtë periudhë fokusohet në diskutimet që kanë të bëjnë me pikat e rendit të ditës të cilat i takojnë fushave të sundimit të të drejtës, të drejtat e njeriut dhe të demokracisë. Në atë drejtim, monitorohet ato trupa punuese të kuvendit dhe seancat plenare në fushë-veprimin e të cilave hyjnë fushat e përmendura. Në mënyrë shtesë, në kuadër të projektit janë të përfshira edhe mediet, përkatësisht, monitorohet se si ato raportojnë për punën e Kuvendit. Gjatë monitorimit gjetjet për cilësinë e debatit në Kuvendin dhe për raportimin e medieeve, publikohen në formë të raporteve tremujore.

Para Jush është raporti për cilësinë e debatit në Kuvendin, që ka të bëjë me periudhën prej 1 shtatori deri më 31 dhjetor të vitit 2017.

I. Gjetje kyçe

Në periudhën shtator – dhjetor të vitit 2017 u monitoruan shtatë seanca plenare dhe nëntë debate të komisioneve, ndërsa gjithsej janë monitoruar 1469 diskutime. Tema më të diskutuara ishin Propozim – ligji ishin Propozim – ligji për përdorimin e gjuhëve dhe Propozim – buxheti i Republikës së Maqedonisë për vitin 2018.

Opozita ishte më aktive dhe morri pjesë me 69% nga diskutimet, ndërsa pushteti me 31%. **Deputetë më aktiv që në foltoren e kuvendit u mbajtën më gjatë janë Antonio Milloshovski me 286 minuta, Dragan Cuklev me 223 minuta dhe Ilija Dimovski me 222 minuta.**

Në këtë periudhë të monitoruar mund të konkludohet se ka rënë shkalla e argumentimit të diskutimit parlamentar krahasuar me periudhën paraprahe (maj – gusht të vitit 2017). Në 41% të diskutimeve të analizuara deputetët nuk kanë dhënë argumente, gjë e cila është për 6 pika të përqindjes (p.p) më tepër se sa në periudhën e kaluar. **Mbresëlënese edhe për këtë periudhë është ajo që mes diskutimeve të monitoruar nuk janë identifikuar të tilla në të cilat folësit kanë përdorur më tepër se dy argumente për ta mbështetur pozitën e vet.**

Sipas përkatësisë politike të folësve, **58% nga diskutimet e bëra nga deputetët e pushtetit ka argumentim të dobët, ndërsa në 24% nuk është identifikuar kurrfarë arsytimi në lidhje me temën e diskutimit. 38% të diskutimeve është me argumentim të dobët, ndërsa në 48% të diskutimeve aspak nuk janë identifikuar argumente.**

Në raport me atë se si deputetët u përgjigjen argumenteve të drejtuara nga diskutuesit e tjerë rezulton se **ata në një të tretën e diskutimeve (33%) pjesërisht ju përgjigjeshin argumenteve të drejtuara ndërsa pjesërisht i shtrembëronin ose injoronin. Në 17% të rasteve argumentet u shtrembëruan tërësisht, ndërsa në 8% të rasteve tërësisht u injoruan.**

Me këtë rast, **deputetët nga shumica më tepër ishin ithtarë të asaj që drejtpërdrejtë tu përgjigjen vetëm një pjese të argumenteve, ndërsa të tjerat ose t'i shtrembërojnë ose t'i injorojnë. Te**

deputetët nga opozita përqindja më e madhe e diskutimeve ishte injorimi i plotë argumentet e drejtuara paraprakisht – 18% krahasuar me shumicën – 8%.

Te deputetët mbetet konstante mos-ndryshimi i qëndrimeve dhe të pozicioneve për shkak të argumenteve më të mira të diskutuesve. Në 28% të diskutimeve nuk është vërejtur kurrfarë reference për cilësinë e argumenteve të folësve tjerë.

Për dallim nga periudha e kaluar (maj - gusht 2017) në periudhën e fundit (shtat. – dhjet. 2017) nuk është vërejtur as rast kur deputetët nga opsioni i ndryshëm politik edhe pse nuk e ndryshojnë pozitën e vet prapëseprapë e njohin cilësinë dhe vlerën e argumenteve të bashkëbiseduesve të tyre nga parti të tjera.

Nëse sipas përkatësisë partiake të folësve analizohet transparenca ndaj argumenteve të pjesëmarrësve të tjerë mund të konkludohet se të dy palët ishin të mbyllura në mënyrë të njëjtë për qëndrimet e të tjerëve.

Deputetët, njëlloj si në periudhat e monitoruara paraprakisht, sërish më shpesh vendosnin t’i bëjnë vështrim personalitetit të kolegëve të tyre se sa argumenteve të paraqitura.

Në raportin ndaj personaliteti të deputetëve të tjerë, në 32% të fjalimeve të opozitës është shprehur respektim i pjesshëm, ndërsa në 7% mos-respektim i pjesshëm, ndërsa në 9% mos-respektim. Deputetët nga pushteti në 55% të diskutimeve të analizuara kanë pasur respektim të pjesshëm, në 5% mos-respektim të pjesshëm ndërsa 5% mos-respektim të plotë. Respekti ndaj personaliteti të folësve të tjerë është shprehur në vetëm 2% të diskutimeve të shumicës dhe 1% të atyre të opozitës.

Sipas llojit të diskutimeve në këtë periudhë **pjesa më e madhe shkojnë në replika (38%) dhe kundër-replika (40%), ndërsa 17% nga diskutimet e monitoruara shkojnë në fjalime.** Për dallim nga periudha e kaluar (maj - gusht 2017), **në këtë periudhë 5% të diskutimeve shkojnë në pyetje të deputetëve, pyetje shtesë të deputetëve dhe përgjigje të pyetjeve.**

57% nga pyetjet e deputetëve i takojnë shumicës, ndërsa 43% opozitës. Gjithashtu 67% nga pyetjet shtesë të deputetëve i takojnë opozitës, ndërsa 33% pushtetit.

Në 9% të diskutimeve është shënuar ndërprerje në fjalimin e deputetëve nga deputetët e tjerë.

II. Konteksti politik

Në pajtim me Kushtetutën, Kuvendi e ka pushtetin ligjvënës dhe për momentin është i përbërë nga 120 deputetë. Deputetët zgjedhen në zgjedhje të drejtpërdrejta, përmes listave proporcionale zgjedhore për mandat prej katër vitesh. Në zgjedhjet e fundit parlamentare, të mbajtura më 11 dhjetor të vitit 2016, Partia Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas (OBRM – PDUKM) dhe koalicioni fitoi 51 deputet, Koalicioni Lidhja Social Demokrate e Maqedonisë (LSDM) fitoi 49 deputetë, Ndërsa Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI), fitoi 10 deputetë. Lëvizja Besa fitoi 5 deputetë, Aleanca për Shqiptarët fitoi 3 deputetë, ndërsa Partia Demokratike Shqiptare (PDSH) fitoi 2 deputetë. Mbledhja konstituive zgjati më gjatë se një muaj, kishte 21 vazhime dhe kulminoi më 27 prill të vitit 2017¹ me incident të përgjakshëm në Kuvendin. Kjo seancë u përmbyll më 31 maj të vitit 2017. Mbledhja e parë e rregullt plenare e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë pas ngjarjeve të 27 prillit u mbajt më 30 maj të vitit 2017 me pikë të rendit

¹ Kuvendi nën thjerrëz: Si debatuan debatuan në “seancën më të gjatë konstituive” (gusht, 2017), <http://idsocs.org.mk/wp-content/uploads/2017/08/mk.pdf>

të ditës Zgjedhje e Qeverisë së republikës së Maqedonisë. Struktura e Kuvendit në periudhë të monitoruar ka ndryshuar. Si pushtet dhe shumicë paraqiten Lidhja socialdemokrate e Maqedonisë dhe koalicioni, Bashkimi demokratik për integrim dhe Aleanca për shqiptarët, ndërsa opozitën e përbëjnë OBRM-PDUKM dhe koalicioni, Lëvizja Besa dhe PDSH. Dy deputetë i braktisën radhët e OBRM-PDUKM, me çka koalicioni OBRM-PDUKM tani ka 49 deputetë.

Kjo periudhë, njëlloj si periudha e kaluar u karakterizua me punë jo të rregullt të Kuvendit, me ndërprerje të gjatë nga 25 shtatori deri më 31 tetor, për shkak të zgjedhjeve lokale. Përderisa në muajin tetor fokusi ishte në zgjedhjet lokale, në dhjetor fokusi u zhvendos në drejtimin vjetor të Presidentit të Republikës së Maqedonisë, ndërsa vëmendje më të madhe gjatë tërë periudhës së punës së parlamentit tërhoqi diskutimi për Ligjin për përdorim të gjuhëve.

III. Gjetje nga monitorimi

Lloji i diskutimeve

Në këtë periudhë (shtator - dhjetor 2017) u monitoruan shtatë mbledhje plenare dhe nëntë debate në komisione,² ndërsa gjithsej janë monitoruar 1469 diskutime. Tema më të diskutuara ishin Propozim – ligji për përdorimin e gjuhëve dhe Propozim – buxheti i Republikës së Maqedonisë për vitin 2018. Sipas përkatësisë politike të folësve, nga monitorimi në këtë periudhë rezulton se deputetët nga opozita, e cila është e përbërë nga OBRM-PDUKM, Lëvizja Besa dhe PDSH, ishin më aktiv me 69% të diskutimeve, ndërsa deputetët nga shumica e përbërë nga LSDM, BDI dhe Aleancës për shqiptarët në 31% të diskutimeve të monitoruara.


Grafiku 1



Deputet më aktiv të cilët në foltoren e kuvendit u mbajtën më gjatë janë Antonio Milloshovski me 286 minuta, Dragan Cuklev me 223 minuta dhe Ilija Dimovski me 222 minuta. Sipas asaj se sa herë janë paraqitur për fjalë, sërish deputet më aktiv është Antonio Milloshovski i cili e ka marrë fjalën 72 herë dhe deputetët Dimitar Stevanaxhija dhe Vlladanka Aviroviq me 55 herë. Pesë deputetët e parë më aktiv nga foltorja e Kuvendit janë nga OBRM-PDUKM-ja opozitare.


²Komisioni ligjdhënës juridik, Komisioni për sistem politik dhe marrëdhënie midis bashkësive, Komisioni për financim dhe buxhet, Komisioni për çështje evropiane, Komisioni për transport, lidhje dhe ekologji, Komisioni për mbikëqyrje mbi punën e drejtorisë për siguri dhe kundër-zbulim dhe të agjencisë për zbulim dhe Komisioni për politikë të jashtme.

Grafiku 2



Sipas llojit të diskutimeve në këtë periudhë pjesa më e madhe shkon në replika (38%) dhe kundër-replika (40%), ndërsa 17% të diskutimeve të monitoruara shkojnë në diskutime. Për dallim nga periudha e kaluar (maj - gusht)³, në këtë periudhë u mbajt seancë plenare për pyetje të deputetëve. 5% të diskutimeve shkojnë në pyetje të deputetëve, pyetje plotësuese të deputetëve dhe përgjigje në pyetjeve.


Grafiku 3



Duke i bërë vështrim llojit të diskutimit sipas përkatësisë politike, mund të vërehet se pjesa më e madhe e kundër-replikave (75%) dhe të replikave (63%) i takojnë opozitës. Opozitës i takojnë edhe 69% të fjalimeve, ndërsa 57% të pyetjeve të deputetëve u takojnë shumicës, ndërsa 43% opozitës. Gjithashtu 67% e pyetjeve shtesë të deputetëve i takojnë opozitës, ndërsa 33% pushtetit.

³ Raport nga monitorimi i cilësisë së debatit në Kuvendin (maj – gusht), IDSCS, <http://idscs.org.mk/wp-content/uploads/2018/01/izveshtaj-maj-avgust-2017-mk.pdf>


Grafiku 4



Shkallë e argumentimit

Në këtë periudhë të monitoruar nga diskutimet e vlerësuara mund të konkludohet se ka rënë shkalla e argumentimit të diskutimit parlamentar krahasuar me periudhën e kaluar (maj – gusht 2017). Në 41% të diskutimeve të analizuara deputetët nuk kishin argumente, gjë e cila është për 6 pika të përqindjes (p.p) më tepër se në periudhën e kaluar. Në 44% të diskutimeve është vërejtur argumentim i dobët, përkatësisht folësit ofruan arsyetim të pozicioneve të tyre gjë e cila nuk mjafton që të llogaritet për një argument të plotë. Në 13% të diskutimeve të deputetëve nuk është identifikuar një argument për ta arsyetuar pozitën e tyre, gjë e cila është për 4 p.p. më tepër se në periudhën maj – gusht 2017. Në vetëm 2% të diskutimeve u përdorën 2 argumente. Mbresëlënëse është ajo se mes diskutimeve të monitoruara nuk janë identifikuar të tilla në të cilat folësit përdorin më tepër se dy argumente për ta mbështetur pozitën e vet.


Grafiku 5



Nëse analizohet sipas përkatësisë politike të folësve, 58% të diskutimeve të bëra nga deputetët e pushtetit ishin të argumentuara në mënyrë të dobët, ndërsa në 24% nuk është identifikuar kurrfarë arsyetimi në lidhje me temën e diskutimit në seancën. Në vetëm 16% të diskutimeve të shumicës është identifikuar një argument, ndërsa në vetëm 2% dy argumente. 38% të diskutimeve të deputetëve nga opozita karakterizohet me argumentim të dobët, ndërsa në 48% të diskutimeve të tyre aspak nuk kanë


përdorur argumente. Në vetëm 12% kanë përdorur 1 argument, ndërsa në vetëm 2% të diskutimit të tyre kanë përdorur 2 argumente.

Grafiku 6



Në raport me atë se si deputetët përgjigjeshin në argumentet e drejtuara nga folësit e tjerë rezultojnë se ata në një të tretën e diskutimeve (33%) pjesërisht u përgjigjeshin argumenteve të drejtuara, ndërsa pjesërisht i shtrembëronin ose injoronin. Në 17% të rasteve argumentet ishin tërësisht të shtrembëruara, ndërsa në 8% të rasteve argumentet e folësve të tjerë ishin tërësisht të injoruar. Gjithashtu për shkak të argumentimit të ulët të diskutimit në 36% të rasteve nuk ka argumente të drejtuara ose pyetje nga folës të tjerë, gjë e cila është për 13% më tepër se sa në periudhën paraprake (maj - gusht 2017). Në vetëm 6% të diskutimeve argumentet ishin të adresuara në mënyrë përkatëse pjesërisht folësi është përgjigjur drejtpërdrejtë në argumentet të cilat paraprakisht ja ka dërguar pjesëmarrës tjetër në seancën.

Grafiku 7




Analizuar sipas përkatësisë politike të folësve, rezultojnë se deputetët nga shumica ishin më të prirë që drejtpërdrejtë t'u përgjigjen një pjese të argumenteve të drejtuara, ndërsa të tjerët ose t'i shtrembërojnë ose t'i injorojnë. Përgjigje të tilla janë identifikuar në 44% të diskutimeve. Te deputetët nga opozita e njëjta është vërejtur në 28% të diskutimeve.

Te deputetët e opozitës, ndërkaq, e madhe është përqindja e diskutimeve në të cilat tërësisht injorohen argumentet paraprakisht të drejtuara – 18% krahasuar me shumicën te të cilat është shënuar në 8% të diskutimeve.

Si opozita, ashtu edhe pushteti në vetëm 6% të diskutimeve të tyre i adresuan argumentet në mënyrë përkatëse folësve të tjerë. Në 29% të diskutimeve të pushtetit dhe në 40% të diskutimeve të opozitës nuk ishin drejtuar argumente ose pyetje nga folësit e tjerë në të cilat mund të përgjigjen ose ti adresojnë.


Grafiku 8



Fuqia e argumentit më të mirë

Instituti për demokraci “Societas Civilis” – Shkup e përcjell debatin në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë nga viti 2014. Një nga karakteristikat më mbresëlënëse në të gjitha periudhat e monitorimit të cilësisë së debatit nga viti 2014, është ajo që te deputetët mbetet konstante mos-ndryshimi i qëndrimeve dhe të pozicioneve për shkak të argumenteve më të mira të bashkë-folësve. Raporti i tillë i mos-ndryshimit të pozicioneve gjatë debateve mbetet edhe në këtë periudhë të monitoruar në të cilën nuk është vërejtur folës i cili ka ndryshuar pozicionin e vet për shkak të argumenteve më të mira të folësit tjetër nga një opion tjetër politik. Me atë deputetët nuk demonstrojnë transparencë dhe mundësi që të binden në vlefshmërinë e argumenteve të palës tjetër. Ndërkaq, në 28% të diskutimeve nuk është vërejtur kurrfarë reference për cilësinë e argumenteve të folësve të tjerë. Në 41% të diskutimeve te folësit nuk kishte ndryshim të qëndrimeve, për shkak të të cilës kishin pozitë të njëjtë dhe shprehën mirënjohje për vlefshmërinë e argumenteve të bashkë-partiakëve të tyre. Në 31% të diskutimeve deputetët mbetën në qëndrimin e tyre dhe nuk e pranuan vlefshmërinë e argumenteve të diskutuesve të tjerë nga opsionet e tjera politike. Për dallim nga periudha e kaluar (shtat. – dhjet. 2017) nuk është vërejtur asnjë rast kur deputetët nga opsioni i ndryshëm politik prapëseprapë e njohin cilësinë dhe vlefshmërinë e argumenteve të bashkë-diskutuesve të tyre nga parti të tjera.


Grafiku 9



Nëse sipas përkatësisë partiake të folësve analizohet hapja ndaj argumenteve të pjesëmarrësve të tjerë në seancat mund të konkludohet se të dyja palët ishin të mbyllura në mënyrë të barabartë me pikëpamjet e të tjerëve. Deputetët e opozitës në 51% të diskutimeve të tyre iu referuan argumenteve të bashkëpartiakëve me të cilët ishin në të njëjtin pozicion me ç’rast e njihnin vlerën e argumenteve. Në 24% të diskutimeve të tyre nuk ka pasur ndryshim qëndrimi, as njohje të vlerës së argumenteve. Deputetët e opozitës shpesh iu referuan argumenteve të bashkë-partiakëve të tyre.

Në debatet e shumicës në 47% të rasteve nuk kishte ndryshim të qëndrimit dhe vlera e argumenteve të folësve të opozitës nuk u pranua. Gjithashtu, 34% e diskutimeve të qeverisë nuk kishin referencë ndaj vlerës së argumenteve të të tjerëve.

Grafiku 10



IV. Respektim, ndërprerje dhe kufizime

Raport ndaj argumenteve dhe personaliteti të deputetëve nga partia tjetër

Shfaqja e formave të ndryshme të mosrespektimit ndaj folësve ose argumenteve të tyre mund të ndryshojë atmosferën eventuale korrekte, e cila është parakusht themelor për zhvillimin e një debati racional dhe argumentues. Në të njëjtën kohë, mund ta ndryshojë rrjedhën e diskutimit dhe fokusin e ligjvënësve nga argumentet që të orientohet në sulme dhe fyerje, duke e polarizuar më tej atmosferën dhe duke mos e lejuar debatin thelbësor.

Ligjvënësit, si dhe në periudhat e vëzhguara më parë, kanë vendosur në mënyrë të përsëritur t'i referohen personalitetit të kolegëve të tyre sesa të argumenteve të referuara.

Në 31% të diskutimeve ata shprehën respekt të pjesshëm për argumentet, ndërsa respektim të pjesshëm ndaj personalitetit të deputetëve është shprehur në madje 39% të diskutimeve. Kjo do të thotë që deputetët pjesën më të madhe të diskutimeve nuk i rezistuan që të bëjnë shprehje tallëse ose të buta abuzive dhe sulme ndaj personalitetit të kolegëve të tyre nga opsionet e kundërta politike **Me këtë rast, respektim për argumentet dhe personalitet shprehet në vetëm 1% të rasteve.** Në 7% të diskutimeve të monitoruara është vërejtur mos-respektim i pjesshëm ndaj personaliteti të kolegëve të tyre, **ndërsa madje në 8% të diskutimeve është vërejtur mos-respektim i plotë.** Në këto raste folësit në diskutimet e veta shfaqën mos-respektim të plotë ndaj personalitetit të deputetëve të tjerë – duke përdorur fjalë të rëndë fyes. Në 67% të diskutimeve folësit nuk kanë shfaqur kurrfarë raporti të respektimit ose mos-respektimit ndaj **argumenteve** të folësve të tjerë, ndërsa në 45% të diskutimeve nuk kanë shprehur kurrfarë raporti ndaj **personalitetit** të folësve të tjerë.

Grafiku 11




Raport ndaj argumenteve dhe personalitetit sipas përkatësisë politike të deputetëve

Deputetët e opozitës në 74% të fjalimeve të tyre nuk kishin referencë, përkatësisht nuk shprehën ndonjë respekt ose mospërfillje të argumenteve të ligjvënësve nga pushteti, ndërsa në 26% të diskutimeve ata kishin respekt të pjesshëm. Deputetët nuk kishin referencë në 53% të diskutimit të tyre, ndërsa në 43% të rasteve është vërejtur respektimi i pjesshëm në argumentet e opozitës.


Deputetët nga pushteti gjithashtu në 2% të fjalimeve të tyre përdorën fjalimin abuziv. Në vetëm 1% të diskutimit të tyre shprehën respekt për argumentet e opozitës.

Grafiku 12



Në lidhje me personalitetin të deputetëve të tjerë, në 32% të fjalimeve të opozitës është shprehur respekt i pjesshëm, në 7% mos-respektim të pjesshëm, ndërsa në 9% mos-respektim. Në 51% të diskutimeve, deputetët nga opozita nuk kanë pasur referencë ndaj personalitetit të deputetëve të tjerë. Deputetët nga pushteti në 55% të diskutimeve të analizuara kishin respekt të pjesshëm, në 5% mospërfillje të pjesshme dhe 5% mospërfillje totale. Në 32% të diskutimit të tyre ata nuk kishin referencë ndaj personaliteteve të deputetëve të opozitës. Është e rëndësishme të theksohet se në vetëm 2% të fjalimeve të tyre deputetët nga pushteti dhe 1% të deputetëve nga opozita shprehën respekt për personalitetin e kolegëve të tyre nga një parti tjetër politike.

Grafiku 13




Deputetët edhe në këtë, si në periudhat e mëparshme, rrallë kanë përdorur histori, anekdota ose dëshmi në diskutimet e tyre. Elemente të tilla vërehen në gjithsej 6% të diskutimeve.

Në 9% të diskutimeve është vërejtur ndërprerje në fjalimin e folësit nga deputetët e tjerë. Këto janë ndërprerje në kohëzgjatje deri më së shumti prej 10 sekonda të shkaktuara nga hedhje fjalësh dhe brohoritje ndaj folësit nga deputetët të cilët për momentin nuk kanë marrë fjalë. Pas ndërprerjeve folësit i vazhduan prezantimet e tyre.

Demografia e folësve

Struktura demografike e folësve

Grafiku 14



Metodologjia e hulumtimit

Cilësia e diskutimit në Kuvendin analizohet me përdorimin e “Indeksit për cilësi të debatit”. Indeksi është instrument i cili mundëson që çdo akt i veçantë i diskutimit në seancën e monitoruar të kodohet sipas disa karakteristikave kryesore:

- shkallë e argumentimit të fjalimit (sa argumente ka në çdo diskutim);
- shkallë e respektimit të folësit ndaj deputetëve të tjerë dhe argumenteve të tyre;
- qëndrimi i hapur për pranimin e argumenteve të huaja dhe ndryshim të qëndrimeve të tyre për shkak të argumenteve më cilësore të prezantuara në debatin;
- nëse deputetët mund ti shfaqin qëndrimet e veta në mënyrë të papenguar.

Projekti “Kuvendi nën thjerrëz”

Projekti “Kuvendi nën thjerrëz” është i financuar nga Agjencioni Zviceran për përkrahje dhe zhvillim. Në pjesën e aktiviteteve projekti përfshin monitorim 28 mujor të cilësisë së debatit kuvendor dhe monitorim i asaj se si mediet raportojnë për punën e Kuvendit. Monitorimi i debatit kuvendor dhe të raportimit mediatik filloi në shtator të vitit 2015 e do të zgjas deri në dhjetor të vitit 2017 dhe do të përfshijë analizë dhe raporte të njohurive të përfituara nga monitorimi në çdo tre muaj. Në periudhën e projektit do të përpilohen 9 raporte tremujore për cilësinë e debatit në parlamentin dhe 9 raporte tremujore për raportimin e medieve për punën e deputetëve. Në kuadër të projektit do të zbatohen dhe publikohen rezultatet e dy hulumtimeve të mendimit publik në terren për hulumtimin e perceptimit të qytetarëve për punën e Kuvendit.

Projekti paraqet vazhdim i projektit “Kuvendi nën thjerrëz – fuqizimi i debatit politik dhe të diskursit deliberativ”, i cili u financua nga Instrumenti Evropian për demokraci dhe të drejta të njeriut – EIDHR dhe u zbatua në periudhën nga shkurti i vitit 2014 deri në tetor të vitit 2015.



Raport nga monitorimi i cilësisë së debatit në Kuvendin

shtator - dhjetor 2017



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**



**Институт за демократија
Социетас цивилис - Скопје**